Kronikë

Lezhë/ Arrestohet 67-vjeçari, kanosi nipin me armë zjarri për motive pronësie, përshkallëzimi i konfliktit u parandalua (EMRI)

Policia në Lezhë ka arrestuar 67-vjeçarin, Pjetër Nika pas kërcënoi me armë zjarri nipin e tij, për motive pronësie.

Redaksia
11 Maj, 10:43 | **Përditesimi: 11 Maj, 12:08**

Share

LEZHË - Policia ka parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti për motive pronësie në fshatin Mërqi të Lezhës. Pjetër Nika, 67 vjeç u vu në pranga pasi kanosi me armë zjarri nipin e tij F.N., për motive pronësie.

Forcat 'Shqiponja' dhe shërbimet e komisariatit të Lezhës shkuan menjëherë në vendngjarje në Mërqi sapo u mor njoftimi dhe falë ndërhyrjes në kohë u parandaluar përshkallëzimi i konfliktit dhe u sekuestrua arma me të cilin xhaxhai po kërcënonte nipin e tij.

Gjatë kontrollit në banesën e 67-vjeçarit u gjet një sasi municioni luftarak.

LEXO EDHE:
Tragjike në Shëngjin, vdes një tjetër punëtor ndërtimi! 50-vjeçarit i bie dërrasa në kokë! Zhduket personi që e çoi në urgjencë (EMRI+FOTO)

> *'Falë ndërhyrjes në kohë është parandaluar përshkallëzimi i konfliktit dhe është sekuestruar arma e zjarrit pistoletë me municion luftarak, që dyshohet se e posedonte shtetasi P. N., 67 vjeç, banues në Mërqi, Lezhë.*
>
> *Gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi u gjet edhe një sasi municioni luftarak.', thuhet ndër të tjera në njoftimin e policisë.*

Ndërkohë materialet proceduriale i janë kaluar Prokurorisë për dy vepra penale: "Kanosja" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".

G.K/S.Ç/Shqiptarja.com

TAG: Lezhe pjeter nika

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni takimin e Ramës me shqiptarët në Athinë?

Të nevojshëm | Të panevojshëm | Nuk e di

Lajme të tjera

Zbuloni Mirditën, perlën 'e fshehur' mes maleve! Operatorët turistik bashkëpunim me Bashkinë për promovimin e resurseve

Elvis Hila

11 Maj, 12:34

Lezhë/ Aksident në aërsi të kryqëzimit të Shëngjinit, 'Audi' përplaset me shtyllën e ndriçimit

11 Maj, 08:34

Vdekja e punëtorit të ndërtimit në Shëngjin, 28-vjeçari ra nga kati i 9-të që po ndërtohej pa leje! I riu punonte në të zezë, 3 persona në kërkim (EMRAT)

10 Maj, 09:41

Armiku i Martinajt u ekzekutua në qendër të Athinës në sy të djalit, Roan Brahimit në 2020 i qëlluan me armë lokalin e të atit në Lezhë! E shkruara kriminale

10 Maj, 08:12

Kanabisi në Lezhë/ Gjykata e Apelit lë në fuqi vendimin për vëllain e deputetit të PS-së

9 Maj, 14:24

Shëngjin/ Po punonte në një pallat në ndërtim, 28-vjeçari bie nga kati i 9-të dhe vdes (EMRI)

Elvis Hila

9 Maj, 08:52

"Rrno për me tregue", monodrama në Rubik

8 Maj, 18:53

Kampet e emigrantëve, avancojnë punimet në Shëngjin e Gjadër! Emigrantët e parë priten në fund të nëntorit! Report Tv sjell pamjet me dron

Elvis Hila

8 Maj, 12:10

Përkujtohet ditëlindja e heroit kombëtar, Gjergj Kastriotit! Veprimtari në memorialin e Skënderbeut në Lezhë

6 Maj, 11:52

Shëngjin/ 'Rana e Hedhun' tërheq turistët e tuaj me kampera: Perlë e bregdetit shqiptar, ia vlen të vizitohet

Elvis Hila

5 Maj, 16:03

'Veri- Jug' në Patog të Kurbinit! Peshkatari që 'sfidon' dallgët prej 50 vitesh: Profesion i vështirë, por ia dola të shkolloj fëmijët në Akademinë e Arteve

Agim Pipa

5 Maj, 14:20

VIDEO/ Aksident i fortë në aksin Lezhë-Shëngjin, makinat 'shkërmoqen', 2 të plagosur

5 Maj, 13:48

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Getbutto

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje